


# MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

mes



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*  
*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

dhe



**Fondacioni Suedez Trashëgimia Kulturere pa Kufij, Zyra në Kosovë**

*rreth implementimit të*  
*Programit "Integrimi i trashëgimisë kulturore në planifikim hapësinor dhe urban të*  
*nivelit qendror dhe lokal në Kosovë"*

## Palët

### Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)

Kontakt personi: Z. Arben Çitaku, UD Sekretar Permanent, MMPH  
Adresa: Ndërtesa e re e Qeverisë së Kosovës - ish Pallati i Mediave "Rilindja" kati 17,  
nr.1705, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Telefon: +381 (0)38 200 32307  
Faks: -  
E-mail: arben.citaku@ks-gov.net

### Trashëgimia Kulturore pa Kufij, zyra në Kosovë

Kontakt personi: Z. Sali Shoshi, Drejtues i Zyrës - Zyra e CHwB në Kosovë  
Adresa: Qyteza Pejton, Rr. R. Zogovic 9, 10000 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Telefon: +377 (0) 44 167 008, +381 (0) 38 243 918  
Faks: +381 (0) 38 243 918  
E-mail: sali.shoshi@chwb.org

## Neni 1: Subjekti i Memorandumit

Ky Memorandum Mirëkuptimi (MM) është vendosur mes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ("MMPH") dhe **Cultural Heritage without Borders**, ("CHwB") - Trashëgimia Kulturore pa Kufij (më poshtë referuar si "Palët") për implementim të Programit - **Integrimi i trashëgimisë kulturore në planifikim hapësinor dhe urban të nivelit qendror dhe lokal në Kosovë** (tani e tutje referuar si "Programi").

## Neni 2: Programi

### *Definicioni i Programit*

Trashëgimia natyrore dhe kulturore e një qyteti përfshinë pjesë të veçanta topografike të kufizuara të peizazhit, të formuara nga kombinacione të ndryshme të veprimeve kulturore dhe natyrore, të cilat ilustrojnë evoluimin e shoqërisë njerëzore, vendbanimin dhe karakterin e saj në kohë dhe hapësirë. Këto elemente përfaqësojnë vlerat e njohura sociale dhe kulturore në nivelet e ndryshme territoriale, për shkak të prezencës së mbetjeve materiale që reflektojnë aktivitetet dhe përdorimin e tokës në të kaluarën, aftësitë ose traditat dalluese, ose përshkrimi në veprat letrare ose të artit, ose fakti që ngjarjet historike kanë ndodhur në atë vend. Planifikimi konservues, si një trend global, është një fushë që po zhvillohet shpejtë dhe e cila ka mundësuar një ndryshim nga mbrojtja 'ad hoc' në një planifikim sistematik që merr parasysh strukturën, procesin dhe këmbënguljen në biodiversitetit. Kohëve të fundit, vëmendja është përqendruar në përfshirjen e realiteteve socio-ekonomike në planifikim konservues, veçanërisht në aspektin e minimizimit të kostove menagjeriale dhe të mundësive të mbrojtjes.



## *Prapavija*

Që nga viti 2004, CHwB është duke punuar me projektet e bazuara në parimet e Konservimit të Integruar. Objektivat kryesore të një politike të konservimit të integruar janë adoptimi i masave për ruajtje, mbrojtje, restaurimi dhe përforcimi të ndërtesave dhe lokacioneve, dhe integrimi i këtyre aktiveve në ambientin fizik të shoqërisë bashkëkohore. Nëpërmjet programeve të rivitalizimit dhe të rehabilitimit të cilat respektojnë qasjen pjesëmarrëse, autenticitetin historik të ndërtesave dhe të lokacioneve me rëndësi monumentale dhe kulturore, ne do të arrijmë mbrojtjen dhe rindërtimin e këtyre simboleve të cilat janë njëra nga kushtet për pajtimin etnik dhe religjioz në këto anë.

Disa nga projektet e përfunduara të CHwB-së janë: Pilot Plani për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Isniqit (Komuna e Deçanit), Pilot Plani për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Rugës Historike të Deçanit, Pilot Plani për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Dranocit (Komuna e Deçanit), Programi për Rehabilitimin e Prizrenit, dhe së fundmi Plani për Ruajtjen dhe Zhvillimin, Plani Zhvillimor Komunal, Plani i Zhvillimor Urban, Plani Rregullativ Urban për Junikun, seminare të ndryshme rreth Rregulloreve të Mbrojtjes, seminare të përbashkëta me UN HABITAT-in në lidhje me trajtimin e trashëgimisë kulturore në Planifikimet e Zhvillimit Urban të Komunave.

Objektivi i përgjithshëm i programit është të kontribuojë në përforcimin e rolit të institucioneve në integrimin e trashëgimisë kulturore në procesin e planifikimit hapësinor në Kosovë si dhe trajtimi i trashëgimisë kulturore si një faktor i zhvillimit lokal.

Qëllimi i programit është të përmirësojë kapacitetet e Komunave që kanë të bëjnë me çështjet e trashëgimisë kulturore në kontekstin e planifikimit urban. Kjo do të arrihet me një bashkëpunim të ngushtë me institucionet qendrore, si Ministria e Planifikimit Hapësinor / Instituti për Planifikim Hapësinor, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe e Sportit, Komuna të ndryshme, UN HABITAT-i, etj.

Grupet e synuara janë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor/IPH, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve/QRTK, stafi i Departamentit përkatës të Komunave të ndryshme të Kosovës, ekspertët lokal dhe ndërkombëtarë, studentët, etj.

## *Rezultatet e pritura*

- Komunitat e përfshirë kanë identifikuar potencialet e trashëgimisë kulturore të cilat do të jenë të integruara në planet lokale të zhvillimit.
- Kapacitetet e implementimit në departamentet e ndryshme, si ajo e Departamentit të Urbanizmit (Niveli Komunal) dhe të Instituteve për Mbrojtjen e Monumenteve (Niveli Qeveritar) janë të përforuara me përfshirje, pjesëmarrje dhe trajnime gjatë tërë procesit. Komunikimi në mes të dy sektorëve është përforcuar po ashtu.
- Janë mbajtur kampanja të vetëdijesimit institucional në lidhje me rëndësinë e inkorporimit të trashëgimisë kulturore në procesin e planifikimit urban.

### **Neni 3: Qëllimet e Palëve**

Duke u bazuar në objektivat e mësipërme dhe rezultatet e parashikuara të Programit;  
Duke e marrë parasysh që zonat e trashëgimisë natyrore dhe kulture të komunave kane nevojë trajtim profesional në rehabilitim, konservim dhe masa mbrojtëse;  
Duke e marrë parasysh që MMPH / IPH dhe CHwB, me përvojën e tyre të gjerë në planifikim hapësinor dhe urban si dhe mbrojtje dhe zhvillim të planeve për zona me vlera historike e kulturore;

Palët pajtohen që të punojnë së bashku në implementimin e Programit në mënyrë që të fokusohet në objektiva, përfshirë këtu edhe palët relevante të tjera.

### **Neni 4: Përgjegjësitë e palëve**

MMPH / IPH do të jetë përgjegjëse:

- Të hartojë dhe ofrojë listën e ekspertëve që do të angazhohen gjatë implementimit të Programit
- Të ofrojë ekspertizën e saj gjatë planifikimit dhe implementimit të Planeve Operacionale si pjesë e Programit të lartpërmendur
- Të ndihmojë qëndrueshmërinë e Programit dhe Projekteve brenda Programit
- Të përkrahë Programin politikisht dhe teknikisht duke ju dhënë stafit mundësinë për të marrë pjesë në projekte që do të organizohen në kuadër të Programit
- Të kontribuojë në ndërtimin e kapaciteteve brenda Programit
- Tek projektet e përbashkëta me CHwB të konsultohet edhe me institucione tjera relevante në nivel qendror

CHwB do të jetë përgjegjëse:

- Te hartoj Planin Operacional ne konsultim me MMPH / IPH. Plani Operacional i bashkëngjitet si Shtese këtij Memorandumi
- Të ofrojë ekspertizën e saj gjatë implementimit të Programit
- Për koordinimin e Programit deri në fund të vitit 2011
- Për kompensim të ekspertizës së stafit të MMPH / IPH, nëse Programi paraqet ngarkesë në punët e përditshme të stafit profesional gjatë implementimit të Programit

### **Neni 5: Ndarja e informatave me palë të treta**

5.1 Pas marrëveshjes së dyanshme me shkrim, Palët mundën t'u japin palëve të treta raporte zyrtare dhe infomata të tjera nga aktivitetet që dalin nga ky MM.

### **Neni 6: Pajtueshmëria me ligjin**



6.1 Ky MM do të implementohet në pajtim me ligjet e zbatuara të Republikës së Kosovës.

6.2 Ky MM nuk do të jetë në kundërshtim me asnjë marrëveshje bashkëpunimi që Palët e kanë me palë të treta.

### Neni 7: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

7.1 Palët do të zgjidhin në mënyrë miqësore, me bisedime, të gjitha mosmarrëveshjet, kundërthëniet apo ankesat që dalin, apo janë të lidhura me këtë MM.

### Neni 8: Zgjatja, amandamenti

8.1 Palët mundën, me marrëveshje të dyanshme me shkrim, të zgjasin apo amandamentojnë këtë MM.

### Neni 9: Përkthimi

9.1 Në rast të ndonjë ndryshimi në përkthim të këtij MM-i, versioni në anglisht do të mbizotërojë.


### Neni 10: Hyrja në fuqi dhe përfundimi i marrëveshjes

10.1 Ky MM do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

10.2 Ky MM do të implementohet deri më 31 Dhjetor 2011, me mundësi të vazhdimit nëse palët konsiderojnë se kanë interes të përbashkët të vazhdimit të bashkëpunimit.


Nënshkruar më 12 Prill 2011, në Prishtinë dhe atë në Gjuhë angleze dhe shqipe, secila nga 2 kopje, me tekste autentike.

Për MMPH




(nënshkrimi dhe vula)

Z. Arben Çitaku, UD Sekretar Permanent,  
MMPH



Për CHwB



(nënshkrimi dhe vula)

Z. Sali Shoshi, udhëheqës i zyrës së CHwB  
në Kosovë

